



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

C-IV.-13-0096

Parashtruesi i ankesës:

R. M, Komuna e Vushtrrisë, i përfaqësuar nga avokati A. V, J, Prishtinë

Kundër

Pala kundërshtare:

Ndërmarrja Shoqërore “L”, e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Agim Ramadani”, Nr. 23, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme) gjyqtarja Manushe Karaçi më 20 maj 2020, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

- I. Ankesa refuzohet si e pabazuar ndërsa vendimi i Autoritetit të Likuidimit MIT027-0263 i datës 21 shkurt 2013 vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**
- II. Në këtë çështje juridike nuk caktohen taksa gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Më 7 mars 2013 Dhoma e Posaçme ka pranuar ankesë nga parashtruesi i ankesës kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, me të cilën kërkon shtatë pagat e papaguara për periudhën e pasaktësuar në shumë prej 414.00€ nga Ndërmarrja Shoqërore “L”, dhe shpenzimet e procedurës.

Kësaj ankese parashtruesi si provë i ka bashkëngjitur:

- *Kopjen e vendimit të AKP-së sipas kërkesës MIT027-0263 të datës 21 shkurt 2013, për*

- refuzimin e kërkesës së paraqitur nga Parashtruesi i ankesës;*
- *Kopjen e njoftimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës të datës 22 korrik 2005.*

Më 20 mars 2013 gjyqtari i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme i dërgon parashtruesit të ankesës një urdhër që në afat prej pesëmbëdhjetë ditëve nga pranimi i urdhrat mes tjerash të dorëzojë në Gjykatë autorizimin për përfaqësim.

Më 15 prill 2013 ankuesi dorëzon në Gjykatë autorizimin e noterizuar në të cilin theksohet se do të përfaqësohet nga a. A V J 'J' Prishtinë.

Parashtruesi i ankesës kishte paraqitur kërkesë të pasafatshme pranë Autoritetit të Likuidimit më 13 mars 2006, me të cilën kishte kërkuar kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 414.00€ nga Ndërmarrja Shoqërore "L".

Më 21 shkurt 2013 Agjencia Kosovare e Privatizimit nxjerr vendimin sipas kërkesës MIT027-0263, me të cilin refuzon kërkesën e parashtruesit të ankesës si të pavlefshme.

AKP-ja e refuzon kërkesën si të pavlefshme duke ju referuar Nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në i cili parasheh që parashtruesit gëzojnë të drejtën për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të punës nëse 'janë pushuar nga puna si pasojë e, ose në lidhje me, një veprim të AKP-së sipas Nenit 6.1 ose 6.2'.

AKP-ja në këtë vendim thekson se Autoriteti i Likuidimit ka marr parasysh Marrëveshjen e Angazhimit, pjesë e privatizimit me Spin-Off Special të NSH 'L' të nënshkruar më 21 korrik 2005. Kjo marrëveshje në nenin 3, paragrafi 3.1 deklaron se Kompania do të, dhe Blerësi do të garantoj që Kompania do të punësoj një minimum prej 250 punëtorëve me orar të plotë në Kompani më datë që është gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje dhe të mbaj fuqinë punëtore së paku në këtë nivel për një gjashtëmujor tjetër'.

Tutje AKP-ja në vendimin e saj argumenton se parashtruesi i ankesës është punësuar nga Ndërmarrja e Re në pajtim të plotë me Marrëveshjen e Angazhimit dhe se nuk është liruar nga puna pas privatizimit.

Në bazë të Nenit 37 të Ligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjyqtarja e Dhomës së Posaçme nxjerr një urdhër me të cilin ankesa e dorëzuar nga parashtruesi i ankesës i dërgohet AKP-së për përgjigje në ankesë.

Më 17 mars 2020 AKP-ja dorëzon mbrojtjen e saj ndaj ankesës së parashtruesit të dorëzuar më 7 mars 2013 kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit MIT027-0263 të NSH "L" (në likuidim).

AKP-ja përmes mbrojtjes së saj kërkon nga Dhoma e Posaçme që të refuzojë ankesën si të papranueshme dhe/ose të pabazuar, dhe të vërtetojë (lë në fuqi) Vendimin e Autoritetit të Likuidimit MIT027-0263 të datës 21 shkurt 2013.

Në mbështetje të mbrojtjes së saj AKP-ja bashkëngjet:

- *Kopjen e vendimit të AKP-së sipas kërkesës MIT027-0263 të datës 21 shkurt 2013, për*

refuzimin e kërkesës së paraqitur nga Parashtruesi i ankesës;

- *Kopjen e Marrëveshjes së Angazhimit, pjesë e privatizimit me Spin-Off Special të NSH 'Lamkos' të nënshkruar më 21 korrik 2005.*

Për më tepër, AKP-ja në mbrojtjen e saj thekson se kërkesa e parashtruesit nuk është refuzuar për shkak se është dorëzuar jashtë afatit për parashtrimin e ankesave ngase një konstatim i tillë është i qartë edhe nga vetë Vendimi i cili në paragrafin 2 të kërkesës thekson se 'kërkesa nuk është refuzuar mbi bazën e pranueshmërisë'.

Gjykata për rastin në fjalë merr për bazë provat e parashtruara nga të dyja palët dhe lëshohet në merita të lëndës.

Arsyetimi Ligjor

Vendimi lëshohet pa mbajtur seancë dëgjimore sepse faktet dhe provat e deponuara në lëndë janë mjaft të qarta, andaj gjyqtari individual nuk pret që në seancë të ketë më tepër informacione dhe argumente në kuptim të nenit 72 paragrafi 11 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (Nr. 06/L-086).

Ankesa e parashtruesit refuzohet si e pabazuar ndërsa vendimi i Autoritetit të Likuidimit MIT027-0263 i datës 21 shkurt 2013, vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Interpretimi i mësipërm është në linjë me jurisprudencën e qëndrueshme të Dhomës së Posaçme. [*Shih, për shembull: lëndët AC-I-15-0029 të datës 8 qershor 2017, AC-I-15-0051 të datës 27 korrik 2017, AC-I-16-0187 të datës 23 shkurt 2017 etj.*].

Paditësi ka kërkuar shtatë pagat e papaguara për periudhën e pasaktësuar në shumë prej 414.00€ nga Ndërmarrja Shoqërore "L", dhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata për rastin në fjalë merr për bazë Nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në i cili parashihet që parashtruesit gëzojnë të drejtën për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të punës nëse 'janë pushuar nga puna si pasojë e, ose në lidhje me, një veprim të AKP-së sipas Nenit 6.1 ose 6.2'.

Në bazë të nenit 31, paragrafi 1 i Ligjit Nr. 06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës i cili përcakton se: '*Palët, në parashtrësit e tyre me shkrim, duhet të paraqesin një pasqyrë gjithëpërfshirëse të fakteve që ato palë i dinë, apo me arsye besojnë të jenë relevante apo materiale për kërkesën, lëndën, procedurën apo rastin përkatës*'.

Me nenin 76 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës parashihet që: '*në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore*'.

Sipas nenit 7, paragrafi 1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore parasheh që: *Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.*

Në bazë të provave të paraqitura Gjykata konstaton se parashtruesi i ankesës është punësuar nga Ndërmarrja e Re në pajtim të plotë me Marrëveshjen e Angazhimit dhe se nuk është liruar nga puna si pasojë e një veprimi të ndërmarrë nga AKP-ja por ka vazhduar punën në bazë të nenit 3, paragrafi 3.1 i Marrëveshjes së Angazhimit, pjesë e privatizimit me Spin-Off Special të NSH 'L' të nënshkruar më 21 korrik 2005.

Në vështrim të provave të paraqitura gjykata gjen se parashtruesit të ankesës nuk iu është ndërprerë marrëdhënia e punës sipas Nenit 6.1 ose 6.2' të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në prandaj nuk i takon e drejta për përfitime nga ndërprerja e parakohshme e kontratës së punës.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile ankesa është e pabazuar. Duke pasur parasysh afatin e parashkrimit në bazë të dispozitave të lartcekura ligjore Gjykata ishte e obliguar që padinë e paditësit ta refuzojë në tërësi si të pabazuar ashtu siç u tha në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Shpenzimet Gjyqësore:

Duke u bazuar në Nenin 62 paragrafi 5 i Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme secila palë i bartë shpenzimet e veta.

Në bazë të Nenit 13, paragrafi 13.3 i Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, në këtë lëndë ankuesi lirohet nga pagesa e taksës gjyqësore sepse lartësia e shumës së kërkuar me padi është nën 1,000.00 euro.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.

**GJYQTARJA,
Manushe Karaçi**